



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:003513
Datë: 31.07.2024
Numri i dokumentit: 06001952

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me Gjyqtaren Blerina KURTAJ, në çështjen juridike përmbartimore të kreditores V. J. nga e Gjakova, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër debitores Komuna e Gjakovës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjakovë, e përfaqësuar nga përfaqësuesja ligjore Vlora Rrahmani, me autorizim në shkresa të lëndës, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitorja kundër Aktgjykimit C.nr.2235/23 të datës 28.05.2024, jashtë seancës gjyqësore, me 31 Korrik 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit i ushtruar ndaj urdhrorit përmbartimor të përmbartuesit privat , *Gëzim Gjoshi P.nr.1407/24 i datës 12.07.2024*, mbi lejimin e përmbartimit.
- II. Ankesa kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbartimore.

A r s y e t i m

Kreditori, përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate me datë 15.07.2024, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitores Komuna e Gjakovës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjakovë, në bazë të dokumentit përmbartues – Aktgjykimit C.nr.2235/23, të datës 28.05.2024, i plotfuqishëm nga data 11.06.2024 dhe i ekzekutueshëm nga data 21.06.2024.

Përmbartuesi privat *Gëzim Gjoshi me seli në Gjakovë, me urdhërin përmbartimor P.nr.1407/24 i datës 12.07.2024* ka lejuar përmbartimin sipas propozimit të kreditorit në këtë çështje përmbartimore.

Ndaj urdhrit të lartcekur, me datën 15.07.2024, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim debitori, duke theksuar se e kundërshtim në tërësi propozimin për përmbartim për shkak se në tërësi është i pa bazuar. Duke theksuar ndër të tjera se për kreditorin është i pa pranueshëm pretendimi i kreditorit që përveç kredisë kryesore kërkon edhe shpenzimet procedurale , për shkak se kërkesat lidhur me këto shpenzime janë në kundërshtim me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve. Ka propozua që të hedhet poshtë si i pa bazuar Urdhëri përmbartimor për lejimin e ekzekutimit, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

I autorizuari i kreditorit ka paraqitur përgjigje në prapësim, me propozim që gjykata ta refuzoj prapsimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhërin përmbartimor të përmbartuesit privat ta vërtetoj si të bazuar, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës. Ndër të tjera ka theksuar se çdo avokat që ushtron veprimtari ekonomike me ofrimin e shërbimeve të avokatisë duhet të jetë i regjistruar në ARBK, dhe avokatura e cila i ka ofruar shërbime kreditores është e regjistruar si SH.P.K, dhe posedon certifikatë të leshur nga Administrata tatimore e Kosovës të cilës i paguan TVSH (më gjerësisht si në prapsimin dhe plotësimin e prapësimit si në shkresa të lëndës).

Gjykata duke bërë shikimin e shkresave të lëndës, pas vlerësimit të prapësimit të debitorit dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe plotësimin të përgjigjes, gjeti se:

- prapësimi është në tërësi i pa bazuar.

Me nenin 21 të Ligjit për procedurën përmbartimore është paraparë që “*organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*”.

Në rastin konkret kreditori ka kërkuar lejimin e propozimit për përmbartim për inkasimin e mjeteve monetare sipas *dokumentit përmbartimor – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në*

Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, C.nr.2235/23 të datës 28.05.2024, i plotfuqishëm nga data 11.06.2024 dhe i ekzekutueshëm nga data 21.06.2024, i cili aktgjykim ka titull përmbarues, duke u bazuar në nenin 22 paragrafin 1, nën par.1.1. të LPP-së ku në mënyre eksplicite parashihet se: “ par.1 Dokumentet përmbaruese janë: 1.1. vendimi përmbarues i gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësor përmbarues;”, dhe ky vendim është i përmbarueshëm në bazë të nenit 24 par 1 të LPP-së, ku theksohet se “ vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbarueshëm po që se ka marrë formën e prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushjen vullnetare “, pasi që i njëjti ka marrë formën e prerë me datë 11.06.2024, si dhe ka skaduar afati për përmbushje vullnetare dhe i njëjti është bërë i ekzekutueshëm që nga data 21.06.2024, si dhe njëkohësisht është edhe i përshtatshëm për përmbarim në kuptim të nenit 27 par.1 të LPP-së, ku thuhet se “Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, pasi që në aktvendimi sipas së cilit është lejuar urdhri përmbarimor janë të përfshira të gjitha këto elemente, andaj gjykata ka vlerësuar së ky vendim i plotëson të gjitha kushtet e lartcekura ligjore për tu caktuar dhe zbatuar përmbarimi sipas tij.

Gjykata vlerësoi pretendimin e debitorit si në prapsim, mirëpo gjykata lidhur me këtë pretendim erdhi në përfundim se një pretendim i tillë është i pa bazuar dhe pambështetje ligjore, pasi që gjykata vetëm vlerëson se dokumenti përmbarimor në bazë të cilit është lejuar përmbarimi i plotëson kushtet e parapara ligjore që të mund të konsiderohet dokument përmbarimor, po ashtu në shkresa të lëndës dokumenti përmbarimor është i bashkangjitur në versionin origjinal i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm, dhe ka gjykata ka vlerësuar që nuk ka pengesa ligjore për lejimin e përmbarimi.

Gjykata aktvendimin përkitazi me refuzimin në rastin konkret e ka mbështetur edhe në nenin 71 të LPP-së, pasi që gjeti se pretendimet e paraqitura në prapësim nga ana e debitorit nuk hyjnë në shkaqet e parapara me këtë nen, të cilat po që se ekzistojnë mund të pengojnë përmbarimin e lejuar, si dhe në nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së, ku theksohet se “baza e prapësimit duhet të mbështetet me provat e duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”, pasi që debitori nuk ja ka bashkangjitur as edhe një provë të vetme me shkrim prapësimit, e cila do të mund të ndryshonte mënyrën e vendosjes së këtij aktvendimi.

Në pikën II (dy) të dispozitivit të këtij aktvendimi gjykata është bazuar në nenin 77 paragrafi 5 të LPP-së.

Gjykata në kuptim të nenit 73 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil-
2024:003513, me 31 Korrik 2024

G J Y Q T A R J A

Blerina KURTAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.